

KONTRATË DHURIMI KUOTE

Në Tiranë, sot më datë 14/01/2025 (dymijë e njëzetë e pesë) në adresën: Lagja nr. 17, Rruga "Stef Kaçulini", Ambjenti nr.3, Hyrja nr. 2, Zona Kadastrale 8515, nr.pasurie 5/2650+2-n3, Durrës, u paraqitën personalisht palët kontraktuese si më poshtë:

Dhuruesi: Z. Renaldo Zaimaj, lindur në Frashër, Shqipëri, i datëlindjes 16.06.1985, mbajtës i Letërnjoftimit nr. I50616184G, madhor dhe me zotësi të plotë juridike e për të vepruar;

(ne vijim e për efekt te kësaj Kontrate referuar si "Dhuruesi")

Dhe

Përfituesi i dhurimit: Z. Rako Paja, lindur në Çorrotat, Shqipëri, i datëlindjes 04.07.1982, mbajtës i Letërnjoftimit nr. I20704004O, madhor dhe me zotësi të plotë juridike e për të vepruar;

(ne vijim e për efekt te kësaj Kontrate referuar si "Përfituesi i dhurimit")

Palët e mësipërme ne vijim dhe për efekt te kësaj Kontrate, do te referohen individualisht si "Pale/a" dhe se bashku si "Pale/et".

HYRJE:

A. Dhuruesi është zotërues i një Kuote (Kuota) që përfaqëson 20 % (njëzetë përqind) të kapitalit të regjistruar të shoqërisë "ECO GROUP -Tomorrica" sh.p.k (ne vijim "*shoqëria*"), shoqëri tregtare me përgjegjësi te kufizuar, e krijuar e qe funksionon ne përputhje me legjislacionin shqiptar, e regjistruar pranë Qendrës Kombëtare te Biznesit me Numër Unik Identifikimi NUIS M32429501H, me objekt te saj nder tjera: "*Ndërtimin e centraleve prodhuese për prodhimin e energjisë të rinovueshme fotovoltaike etj*", kapitali themeltar i regjistruar i së cilës është në shumën ALL 1,000,000 (*një milion*) lekë.

B. Dhuruesi dëshiron t'i dhurojë përfituesit të dhurimit një kuotë që përfaqëson 17 % (shtatëmbëdhjetë përqind) të kapitalit të Shoqërisë "ECO GROUP -Tomorrica" sh.p.k. me NIPT M32429501H.

C. Përfituesi i dhurimit dëshiron te marrë **17 % (shtatëmbëdhjetë përqind)** të kapitalit të Shoqërisë "ECO GROUP -Tomorrica" sh.p.k. të zotëruar nga dhuruesi.

D. Kjo Kontrate shërben për përcaktimin e kushteve, procedurave dhe mënyrës se transferimit te pronësisë dhe pagesave përkatëse lidhur me këtë transferim. Palët konsiderojnë te ligjshme përmbajtjen e kësaj Kontrate dhe marrin përsipër te ekzekutojnë përcaktimet e saj.

PER SA ME SIPER, Palët ranë dakord për te lidhur këtë Kontrate Dhurimi Kuote.

NENI 1

OBJEKTI

1.1. Objekt i kësaj kontrate është kalimi i pronësisë nga Dhuruesi tek Përfituesi i dhurimit të Kuotës që përfaqëson 20 % (njëzetë përqind) të kapitalit të regjistruar të Shoqërisë “ECO GROUP -Tomorrica” sh.p.k. sipas kushteve dhe përcaktimeve të parashikuara në këtë Kontrate.

1.2. Dhurimi në masën **17 % (shtatëmbëdhjetë përqind)** të kuotave të kapitalit të Shoqërisë “ECO GROUP -Tomorrica” sh.p.k., sjell për Dhuruesin humbjen e së drejtës të pronësisë në masën 17 % (shtatëmbëdhjetë përqind), duke mbetur pronar i një kuote në masën e **3 % (tre përqind)**, ndërsa Përfituesi i dhurimit bëhet pronar i një kuote me **62 % (gjashtëdhjetë e dy përqind)** të kapitalit të Shoqërisë “ECO GROUP -Tomorrica” sh.p.k., pa kundërshtpërblim.

NENI 2

KALIMI I PRONËSISË MBI KUOTËN

3.1. Pronësia mbi Kuotën që përfaqëson 17 % (shtatëmbëdhjetë përqind) të kapitalit të regjistruar të Shoqërisë do të kalojë nga Dhuruesi të Përfituesi i Dhurimit pa kundërshtpërblim dhe me regjistrimin pranë QKB-se.

NENI 3

DEKLARATA DHE GARANCI

4.1. Dhuruesi deklaron dhe garanton Përfituesin e dhurimit se:

a. Dhuruesi është zotëruesi i vetëm i 20 % (njëzetë përqind) të kapitalit të regjistruar të Shoqërisë “ECO GROUP -Tomorrica” sh.p.k. dhe ai gëzon gjithë të drejtat e votës dhe çdo të drejtë tjetër që rrjedh nga Kuota dhe ka tagra të plota për të shitur Kuotën e zotëruar prej tij.

b. Shoqëria është një shoqëri tregtare me përgjegjësi të kufizuar, e krijuar e që funksionon në përputhje me legjislacionin shqiptar, në përmbushje të objektit të saj tregtar dhe se nuk ka asnjë pengesë të asnjë lloji për ushtrimin e veprimtarisë tregtare.

c. Shoqëria nuk është në proces likuidimi apo falimentimi dhe ndaj saj nuk ka ndonjë kërkesë për likuidim/faliment dhe në bazë të rezultateve të saj nuk parashikohet të cenohet ekzistenca e saj nga asnjë procedurë likuidimi / falimenti / administrimi të detyrueshëm etj.

d. Kuota është e lire nga çdo barre a peng apo e drejtë tjetër e të tremeve që do të pengonin transferimin e lirshëm sipas kësaj Kontrate.

e. Aktivet e zotëruara nga Shoqëria janë në pronësinë e saj të plotë dhe ligjore dhe titujt e pronësisë dhe të drejtat reale të Shoqërisë nuk cenohen nga asnjë pretendim i asnjë pale të tretë



2

dhe Shoqëria nuk ka detyrime ndaj të tretëve veç atyre që pasqyrohen në librat dhe regjistrimet kontabël të Shoqërisë.

f. Nënshkrimi apo zbatimi i kësaj Kontrate nga Dhuruesi, nuk vjen ne kundërshtim me ligjet, Statutin, kontratat, marrëveshjet apo dokumentet e tjera ligjore ne te cilat Dhuruesi është palë.

g. Dhuruesi deklaron dhe garanton Përfituesin e dhurimit se deklarimet dhe garancitë e dhëna sipas kësaj Kontrate janë te vërteta, te sakta dhe nuk përmbajnë keqinformime ne datën e nënshkrimit.

h. Me lidhjen e kësaj Kontrate, Dhuruesi garanton Përfituesin e dhurimit se do t'i siguroje atij kontrollin efektiv te Shoqërisë në përputhje me te drejtat qe rezultojnë nga zotërimi i Kuotës.

4.2. Dhuruesi deklaron dhe garanton Përfituesin e dhurimit se:

a. Përfituesi i dhurimit ka tagra te plota për të blerë Kuotën sipas kushteve dhe afateve te kësaj Kontrate.

b. Përfituesi i dhurimit është njohur, ka dijeni dhe pranon gjithë dokumentacionin e themelimit, atë administrativ, teknik, financiar dhe kontraktual te Shoqërisë që Dhuruesi i ka vendosur në dispozicion përpara lidhjes se kësaj Kontrate.

c. Nënshkrimi apo zbatimi i kësaj Kontrate nga Përfituesi i dhurimit, nuk vjen ne kundërshtim me ligjet, Statutin, kontratat, marrëveshjet apo dokumentet e tjera ligjore ne te cilat Përfituesi i dhurimit është palë.

4.3. Palët garantojnë se kjo Kontrate përben detyrim ligjor, të vlefshëm, të detyrueshëm dhe të pashmangshëm për palët dhe çdo pasues të tyre të mundshëm, qoftë në vijë trashëgimore, si dhe në rast pjesëtimi pasurie bashkëshortore dhe ose në çdo situatë tjetër duke i qëndruar vetëm qëllimit që i ka paraprirë palët në lidhjen e kësaj Kontrate.

4.4. Palët detyrohen të mbajnë konfidencial të gjithë dokumentacionin, të dhënat dhe çdo informacion tjetër konfidencial të përfituar gjatë marrëdhënies së tyre në Shoqëri.

Neni 4

EFEKTET E KONTRATËS

5.1. Kjo Kontrate hyn ne fuqi me nënshkrimin e saj dhe mund te ndryshohet vetëm me marrëveshje me shkrim te palëve.

5.2. Kontrata ka efekt për palët e treta ne përputhje me dispozitat ligjore.

Neni 5

DISPOZITA TË FUNDIT

6.1. Kjo Kontrate përmban marrëveshjen e plote ndërmjet palëve ne lidhje me objektin e përcaktuar këtu dhe zëvendëson te gjitha marrëveshjet e mëparshme, me goje apo me shkrim, ndërmjet Palëve, ne lidhje me objektin e kësaj Kontrate.

6.2. Kjo Kontratë do të interpretohet dhe zbatohet në përputhje me dispozitat e Ligjit Nr.9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", të ndryshuar, dhe Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë.




6.3. Çdo konflikt apo mosmarrëveshje që lidhet me hartimin, interpretimin apo zbatimin e kësaj Kontrate, që nuk mund të zgjidhet me mirëkuptim ndërmjet Palëve, do të zgjidhet nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Kontrata perpilohet në 4 origjinale të njëjta në gjuhën shqipe me vlerë të barabartë secila. Palet, pasi të lexuan këtë kontratë, dhe se ata e gjejnë atë të rregullt në përputhje me vullnetin e tyre të lirë dhe të plotë, e nënshkruajnë për të gjitha efektet e ligjit.

DHURUESI

Renaldo Zaimaj



PËRFITUESI I DHURIMIT

Rako Paja

